

D. G. - Pashaj
T. 5 për anëtarët për
komitetin vll. 18.12.19



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË
GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . ____

Lënda: PROPOZIM PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË, AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtuar: **Z. Gramoz RUÇI**
KRYETAR I KUVENDIT

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit,

Në zbatim të nenit 114, pika 3 e ligjit 9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në të cilin thuhet:

"Këshilli Drejtues përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se 1 herë. Kuvendi cakton kryetarin, ndërmjet anëtarëve të Këshillit Drejtues. Kryetari i Këshillit Drejtues është drejtuesi ekzekutiv i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare".

Në zbatim të Rregullores së Kuvendit, neni 111 i saj, pika 1 që përcakton se:

"1. Kandidaturat për në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj, të cilat zgjidhen nga Kuvendi, me përjashtim të rasteve kur nuk është parashikuar ndryshe në Kushtetutë ose në ligj, duhet të paraqiten me shkrim nga jo më pak se 28 deputetë dhe të përmbajnë një jetëshkrim të përditësuar të kandidatit dhe pëlqimin e tij për kandidimin."

Ne, një grup prej 28 deputetësh,

– Duke vlerësuar rëndësinë e AKEP, si një autoritet i pavarur, në mbikëqyrjen e tregut të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndën-njet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërnarrësve në këtë sektor.

-Duke vlerësuar se zhvillimet në sektorin e komunikimeve elektronike dhe postare, si një sektor shumë i specializuar dhe me një zhvillim të vazhdueshëm e dinamik, janë shoqëruar me hapa dhe procese të rëndësishme nga pikëpamja e organizimit, menaxhimit dhe administrimit të tij.

I paraqesim Kuvendit për shqyrtim dhe miratim kandidaturën e Z.Tomi FRASHËRI, për funksionin e Kryetarit të Këshillit Drejtues të AKEP, pas zgjedhjes si anëtar i Këshillit Drejtues.

Kandidatura e Z.Tomi FRASHËRI përmbush të gjitha kërkesat ligjore që kërkon ligji nr 9918/2008, i ndryshuar, respektivisht sipas kërkesave të nenit 114 të tij . Duke qenë se kriteret e kandidimit për kryetarin janë të njëjta me kriteret për kandidimin për anëtar, këto përputhshmëri janë shqyrtuar më herët në mbledhjen e datës 10.12.2019, në Komisionin përgjegjës të veprimtarive prodhuese, tregtinë dhe mjedisin, gjatë shqyrtimit të kandidaturës së propozuar me vendim të KM, dhe gjithashtu gjatë dëgjësës me Z.Tomi FRASHËRI.

Në zbatim të pikës 4, neni 114 i ligjit 9918/2008, i ndryshuar: "*Anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të jenë specialistë, me arsim të lartë, të kualifikuar, që kanë, të paktën, 10 vjet përvojë pune dhe të jenë përfaqësues nga sektori i komunikimeve elektronike, postar, i ekonomisë dhe i drejtësisë*".

Ne, deputetët propozues, kemi vlerësuar se karriera e gjatë profesionale dhe përvoja e Z.Tomi FRASHËRI, është një garanci për të rritur rolin dhe funksionet mbikqyrëse rregullatore të AKEP në ushtrimin e veprimtarisë dhe kompetencave në përputhje me të drejtat, përgjegjësitë dhe zbatimin e detyrimeve institucionale të parashikuara në kuadrin ligjor të fushës.

GRUPI I DEPUTETEVE PROPOZUES:

1. Gruen Business 

2. Elona Hoxha 

3. Sadi' Asazi 

4. Shek'it Beutay 

5. Andionis Joku 

6. Xhemal Beutay 

7. Ermonek Valitaj 

8. NIKO PGJESH 

9. Eglantina Gjeneri 

10. Ejo Hysko 

11. Fadil Xosari 

12. Ismet Beutay 

13. Lindita Nikolla 

14. Rahman Ryo 

15. Wilmer Bello Bello
16. Mulekhenar Arkenay
17. Shun Alyes
18. Erin Tushu
19. Antonia Shump
20. Andrea Marto
21. Master
22. Klobleke Bursika
23. Edmond Leke
24. Vullat Tina
25. Drain Kunsaku
26. Amira Khombatta
27. Dadan CBM
28. Oliver Shindly